VENDIM
Nr. 377, datë 25.5.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2016 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen disa ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "... 2181 veta ...".

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjet "Gr. 3 Kryeministria", "Gr. 10 Ministria e Financave" "Gr. 14 Ministria e Drejtësisë" dhe "Gr. 94 Ministria e Zhvillimit Urban" shtohen nënndarjet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në ndarjen "Gr. 3 Kryeministria", nënndarja "Departamenti i Administratës Tatimore" ndryshohet dhe bëhet "Departamenti i Administratës Publike".

3. Në fund të pikës 4, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Punonjësit e kontraktuar për anketime nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të paguhen në të njëjtën mënyrë si punonjësit që merren me anketime të INSTAT-it.".

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij dhe përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

Përjashtimisht, për punonjësit e ALUIZNI-t, efektet financiare të përballohen nga të ardhurat e siguruara nga institucioni.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe institucionet e përmendura në pikën 1 të vendimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela nr. 1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
03	**Kryeministria**	**10**			
	Departamenti i Administratës Publike	10	Specialistë	8 orë/ ditë	Maj-Tetor
10	**Ministria e Financave**	**3**			
	Dega e thesarit Skrapar	3	Specialistë	5 orë/ditë	Maj-Dhjetor
14	**Ministria e Drejtësisë**	**1**			
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	punonjes mirmbajtjeje	5 orë/ditë	Prill-Dhjetor
94	**Ministria e Zhvillimit Urban**	**300**			
	Drejtorite Rajonale te ALUIZNI-t	260	Specialistë	8 orë / ditë	Qershor-Dhjetor
	Drejtorite Rajonale te ALUIZNI-t	40	Teknikë	8 orë / ditë	Qershor-Dhjetor
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	**314**			